Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	



Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. Mikroskop me fluoreshence – 1 copë

Mikroskop trinokular laboratorik për observim me floreshence, dritë të transmetuar dhe kontrast fazor.

Ndriçim LED për dritë diaskopike, i pajisur me lente fluturuese për homogjenitet maksimal të ndriçimit në të gjithë fushën e shikimit. Jetëgjatësia LED të paktën 60,000 orë.

Funksioni i menaxhimit të intensitetit të dritës - ruan automatikisht çdo ndryshim në cilësimet e ndriçimit individualisht për secilin objektiv. Pajisur me një modalitet ECO, i cili fiket automatikisht ndriçimin pas një periudhe të caktuar pasiviteti. Kohëzgjatja e periudhës së pasivitetit është e rregullueshme.

Të ketë ekran në pjesën e përparme të trupit për kontroll të zmadhimit dhe cilësimet e ndriçimit

Me ndricim Köhler, burimi i vendosur në pjesën e pasme të mikroskopit, e pajisur me diafragem të integruar për fushën.

Fokusim koaksial i trashë dhe i imët me kontrolle në të dy anët e trupit; Gama e fokusit të paktën 30 mm.

Tubi trinokular me dy drejtime. Raporti i ndarjes së dritës Okular-Kamera 100%:0 dhe 0:100%.

Të ketë dalje për lidhjen e një kamere me fileto me C-mount

Okularët me zmadhim 10x me një fushë shikimi të paktën 22 mm, të dyja me korrigjim dioptrike dhe kapuc syri prej gome.

Tavolinë mekanike me mundësi rregullimi të lartësisë dhe ngurtësisë së lëvizjes së elementeve të kontrollit në mënyrë të pavarur për të dy akset. Mbajtëse për 2 lama.

Kondensator turret për përdorim me objektiva 4x-100x, me diafragem, i pajisur me module për vëzhgimin e fushës së ndritshme, fushës së errët dhe kontrastit fazor, i rregullueshëm në lartësi dhe i qëndrueshëm.

Gryka rrotulluese me të paktën 6 pozicione për objektiva, me pozicione të koduara – njohje automatike e pozicionit (zmadhimi i objektivit) në software.

Objektiva planfluor (apokromatik gjysem-plan) me korrigjim infinit, për fushë të ndritshme, fushë të errët, kontrast fazor dhe vëzhgim fluoreshence

20X, N.A. të paktën 0.50, distance pune 2.0 mm \pm 0.1mm

40x, N.A. të paktën 0.75, distance pune 0.65 mm \pm 0.1mm

Ndriçues fluoreshente me karusel për të paktën 4 filtra (kuba), me grila mekanike, i pajisur me mekanizëm zhurm-terminator.

Burim drite fluoreshente me diode LED me të paktën katër kanale të pavarura (module LED); diapazoni i ngacmimit të paktën 385-620 nm, sistem ftohjeje natyrale pa përdorimin e ventilatoreve.

Me telekomandë për rregullimin pa shkallë të intensitetit individualisht për çdo kanal ose për të gjitha kanalet njëkohësisht. Lidhja direkte me mikroskop pa përdorur kabull për rrugëtimin e dritës (LLG)

Një grup filtrash fluoreshente me një brez të vetëm (kubë) të optimizuar për burimin LED të ofruar, për ngacmim UV, DAPI (EX 377/50 \pm 3nm DM 409 \pm 3nm BA 447/60 \pm 3nm) dhe jeshil FITC (EX 475/50 \pm 3nm DM 506 \pm 3nm BA 540/50 \pm 3nm) dhe nje kub filtri me dy breza per ngacmim/vezhgim te njekohshem te fluorophoreve DAPI/FITC (EX 387/480 \pm 3nm , DM 403/502 \pm 3nm , BA 433/530 \pm 3nm)

Të shoqërohet me kamera me ngjyra dhe software për marrjen e imazheve në kompjuter.

Të dhënat e kamerës:

Rezolucioni jo më i vogël se 5MP

Sensori: CMOS

Të ketë të paktën 15fps në rezolucion maksimal

Koha e ekspozimit të paktën në diapazonin: 100usec - 30s

Mundësi të kontrollimit të kohës së ekspozimit: ekspozim automatik, ekspozim automatiki i vazhdueshëm dhe ekspozim manual.

Korrigjimi i ekspozimit: \pm 1EV

Ndërfaqja: USB për lidhje me PC dhe shkrepje të jashtme

Montim me c mount

Software të mundësojë marrjen manipulimin dhe dokumentimin e imazheve.

Cilësimet kryesore:

Të kryejë Matje dhe shënime në imazh, marrjen e sipërfaqeve të imazheve në 3D, të mundësojë kryerjen e krahasimeve të imazheve në kohë reale, rregullim të sfondit, të mundësojë krijimin e konfigurimeve optike për metoda observimi si FITC floreshence, krijimi i imazheve me përmirësim të thellësisë së fokusimit (EDF), Time lapse, mundësinë e bashkimit të imazheve të marra nga kanale të ndryshme, filtrimin e imazhit dhe rregullimet e ngjyrave, mundësinë e veprimeve aritmetike të imazheve si shtimi, zbritja dhe shumëfishimi në një imazh ose midis disa imazheve. Krijimin e databazës së imazheve me mundësi renditje dhe filtrimi të imzheve bazuar në madhësin e objektivit, datën, autori, gjenerim të raporteve.

2. Frigorifer laborator – 1 copë

Kapaciteti: 300 - 350 L

Diapazoni i temperaturës: 2-8 °C

Sistem ftohje me ventilim

Saktësia e temperaturës: 0.1°C ose më e mire

Të kryejë shkrije automatike

Të ketë të paktën 5 raftë

Të ketë derë xhami me ngrohje për të shmangur kondensimin në xham.

Të ketë: Ekran LED për shfaqjen e temperature, ndricim të brendshëm me llampë LED, porte USB

Kontrolli të kryhet me mikroprocesor dhe të ketë alarme për temperaturën e ulët dhe të lartë, alarm për fikjen e energjisë, hapjen e derës, dështimin e termostatit.

Furnizimi me energji 220V 50Hz, me konsum jo më shumë se 250W.

3. Kapë Histologjike – 1 copë

Kapë aspirimi për të punuar me mostra histologjike.

Kapa të ketë parafiltër dhe filtër për formalinën si dhe vend për vendosje për filtër HEPA
Të ketë një dalje diametër 230-270 mm për të mundësuar lidhjen me sistemin e aspirimit për të shkarkuar jashtë.

E projektuar për të menjanuar riskun kimik gjatë punës me mostra të ruajtura në formalinë

Dimensionet e brendshme minimale të kapës: Gjerësi 145cm, thellësi 60 cm, lartësi 90cm

Dimensionet minimale të gropës së larjes: Gjerësi 40cm thellësi 40cm lartësi 20cm

Dimensionet minimale të gropës së Formalinës: gjerësi 15cm thellësi 30cm lartësi 10 cm

Dimensionet minimale të depozitës së mbetjeve: 20x20cm

Struktura të jetë e përbërë nga celik inoks i dezinfektueshëm me cepa të rrumbullakosur

Në sipërfaqen e punës të ketë minimalisht një lavaman për ujin e ngrohtë/ftohtë dhe një lavaman më të vogël për shkarkimin e formalinës.

Të ketë rubinet për rregullimin e presionit të ujit të larjes.

Të ketë pllaka celik inoksi me vrima të heqshme të cilat vendosen në sipërfaqen e tavolinës së punës për të punuar.

Shpejtësia e ajrit në pjesën e perparme të kapës: jo më pak se 0.6 m/s

Xhami me ngritje vertikale elektrike me pike ndalimi të poshtme 220 – 240 mm dhe të sipërme 480 – 520 cm.

Të ketë rritje automatike të fuqisë motorike kur ngrihet xhami.

Të ketë raft në pjesën ballore mbi sipërfaqen e punës për vendosje të neve dhe materialeve të ndryshme

Këmbë antistatike të rregullueshme për të mundësuar pozicionin horizontal të sipërfaqes së punës.

Të ketë sistem hedhje të formalinës të përbërë nga një depozitë jo më të vogël se 10L me filtër dhe pompe, rubinet furnizues të kontrolluar me pedale, dhe një depozitë shkarkimi të formalinës jo më pak se 10L me sensor niveli dhe alarme vizuale dhe akustike në rast mbushje.

Një kosh të heqshme me filtër për gropën e formalinës, i cili ndalon bllokimin e shkarkimit dhe mund të hiqet për pastrim.

Kapa të komandohet nga një monitor me prekje.

Në ekran të shfaqen: përqindja e shpejtësisë së ventilimit, alarmet, komandimi i prizave, buton për komandimin e dritës, butoni për uljen dhe ngritjen e shpejtësisë së ventilimit në mënyrën manuale, buton për aktivizimin e ventilimit automatik në funksion të hapjes së xhamit.

Të ketë dritë të brendshme

Të ketë 2 priza për mundësinë e lidhjes së pajisjeve

Të jetë conform direktivës IVDR.

4. UPS On-line – 1 copë

UPS online me fuqi të paktën 10KVA

Niveli i zhurmave: jo më shumë se 55 dB

Tensioni i punës 220V, Monofaze

Faktori i fuqisë: ≥ 0.99

Të ketë të paktën 16 bateri, 12V 9Ah

Ekran ku të shfaqet: Tensioni, Ngarkesa, gjendja e karikimit të baterive, statusi i punës

Të plotësojë standartet e sigurisë: IEC EN 62040-1; EMC IEC EN 62040-2; IEC EN 62040-3

5. Analizator automatik për testime toksikologjike – 1 copë

Sistem automatik për testimin e drogërave, medikamenteve terapeutike me anë të teknologjisë EMIT.

Lista e drogërave dhe medikamenteve terapeutik që pajisja mundëson për të testuar:

(6-Acetylmorphine; Amphetamines, Barbiturates, Benzodiazepines, Buprenorphine, Cannabinoids, Cocaine, Metabolite, Ecstasy EDDP, Ethyl Alcohol, Ethyl Glucuronide, Fentanyl, Ketamine, LSD,

Meperidine, Methadone, Methamphetamine, , Opiates, Oxycodone, Phencyclidine, Propoxyphene, Synthetic Cannabinoids, Tramadol, Amikacin, Caffeine, Carbamazepine, Cyclosporine, Digoxin, Disopyramide, Ethosuximide, Gentamicin, Lamotrigine, Levetiracetam, Lidocaine, Methotrexate, Phenobarbital, Phenytoin, Primidone, Procainamide, Quinidine, Tacrolimus
Theophylline, Tobramycin, Valproic Acid, Vancomycin etj.

Pajisja të kryeje të paktën 130 teste/ore me 2 reagente

Të ketë diapason fotometrik: 0 deri në 3 Abs

Të paktën 8 pozicione për filtra ku të përfshihen filtrat: 340, 415, 505, 546, 570, 600, 660, 700 nm

Rotori i reagenteve të ketë të paktën 12 pozicione për shishe 14ml-16ml dhe 12 pozicione për shishe 28-30ml

Dhoma e reagenteve të jetë me ftohje në temperaturë 8-12°C

Sistemi i reagentëve të ketë detektor niveli dhe përzjeres të integruar.

Të paktën 50 pozicione për mostra dhe 10 pozicione ndihmëse për procese të tjera.

Rotori i mostrave të mund të mbajë tuba 5 ml dhe 10ml me diametër 13 dhe 16mm si dhe sample cups (gota mostre)

Volumi i mostrës 1-30ul për test i programueshëm me hapa nga 0.1ul

Sistemi i pipetimit të jetë i përbërë nga 2 shiringa: 1 shiringë me volum 1000ul për reagentin dhe 1 shiringë 100ul për mostrën.

Të ketë 45 – 50 pozicione për kyveta njëpërdorimshe.

Volumi minimal i matjes jo më shumë se 200ul

Temperatura gjatë matjes të jetë 37°C e kontrolluar nëpërmjet elementit Peltier.

Pajisja të bëjë ndarje të Waste(mbetjeve) në mbetje të holluara dhe mbetje të përqëndruara.

Pajisja të bëjë pastrimin e kyvetave dhe tharjen e tyre përpara përdorimit.

Të ofrojë metoda llogaritje: Regresion linear, spline kubik etj.

Kontrolli i cilësisë të mundësojë deri në 6 kontrole për parametër.

Kontrolli i cilësisë sipas rregullave Westgard dhe kurbave Levey-Jennings ose ekuivalente të tyre.

Të ketë lexues të brendshëm për barkodet.

Të ketë mundësi lidhje me printer.

Të jetë i përfshirë kompjuter me CPU të paktën 2GHz me ekran me prekje me madhësi të paktën 15".

Të ketë portë seriale, USB dhe ethernet.

Të bëhet instalimi dhe trajnimi për përdorimin e pajisjeve. Të furnizohen materialet e nevojshme për vendosjen e pajisjes në punë dhe kryerjen e trajnimit.

6. Dhoma Frigoriferike Morgu për Kufoma – 3 copë

Dhomë Morgu

Dhomë morgu për 4 trupa (2 pozicione, 2 rreshta)

Të ketë dyer të vecanta për çdo pozicion të vendosjes së trupave.

Diapazoni i temperaturës: të paktën nga -5 °C deri në +5 °C

Kushtet e ambientit: të punojë të paktën deri në temperaturë ambienti 32°C

Njësia ftohëse e vendosur në pjesën e prapme të dhomës së morgut

Strukturë celiku e lyster me bojë.

Të ketë panele izoluese me trashësi të paktën 8 cm

Ndarjet e brendshme të jenë inoks

Të ketë të përfshira 4 tabaka për trupat material inoksi me dimensione minimale 210x60

Dimensionet maksimale e jashtme të dhomës pa përfshirë njësinë ftohëse: Thellësia 240 cm; Gjerësia 220cm; lartësia 200 cm

Të ketë panel kontrolli dixhital

Të dhënat e sistemit ftohës:

Tensioni i punës: 230V 50Hz

Fuqia e njësisë ftohëse në modalitet pune dhe gjatë shkrirjes (defrost) : 0.9 – 1.1 KW
Kapaciteti zhvendosës: jo më pak se 2.3 m³/h

7. Karroce ashensor për transport kufomash – 1 copë

Karroca ashensor për transport kufome.

Karroca të jetë e përbërë nga material celik-inoksi

Të jetë me piston hidraulik për ngritje të barelës në lartësi 40 - 170 cm.

Të ketë të paktën 5 rrula celiku me diametër të paktën 50mm në pjesën ku rreshkitet govata e kufomës.

Karrova të ketë pika bllokimi për govatën në pjesën e përparme dhe të mbrapme

Karroca të transportojë barela me gjatësi 200 -215 cm

Karroca të ketë të paktën 2 rrota drejtuese edhe të paktën 2 rrota me frena.

Pesha maksimale mbajtëse: jo më pak se 190kg

Pesha e karrocës hidraulike të jetë jo më shumë se 150 kg.

8. Tavolina laborator – 2 copë

Përmasat e tavolinës: 1500 x 750 mm

Sipërfaqe e punës të jetë xham i temperuar me trashësi të paktën 6mm mbi një suport kundra ujit me trashësi të paktën 20mm.

Struktura e tavolinës të jetë me këmbë metalike me thellësi të paktën 600mm

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie për pajisjet dhe aksesorët shoqërues (kur aplikohet) për një periudhë 2 vjeçare nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku të deklarojë se merr përsipër të kryejë trajnimin e stafit nga punonjës të specializuar për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.
3. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë, ku të deklarojë se garanton riparimin dhe furnizimin me pjesë për pajisjet e ofertuara për një periudhë të paktën 5 vjeçare, si dhe për disponimin e ambientit të servisit për kryerjen e shërbimeve të pajisjeve objekt i këtij prokurimi.



Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Mikroskop me fluoeshence	1	IML	
2	Frigorifer laborator	1	IML	
3	Kape Histologjike	1	IML	
4	UPS On-line	1	IML	
5	Analizator automatik per testime toksikologjike	1	IML	
6	Dhome Frigoriferike Morgu per Kufoma	3	IML	
7	Karroce ashensor per transport kufomash	1	IML	
8	Tavolina laborator	2	IML	

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- ç. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ekstraktin tregetar të rregjistrimit në QKB ku të ketë objekt të veprimtarisë objektin e kontratës.

- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

-
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera mesatare e të paktën njërit prej tyre të jetë **jo me e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*
- b) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

1.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **sa 20% e vlerës së fondit limit** dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera e kontratës dhe fatura tatimore e shitjes ku të evidentohen artikujt**.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e vet të paktën 1 (një) inxhinier elektronik/ inxhinier informatik (ose fusha të ngjashme), të vërtetuar nëpërmjet diplomës, CV-së, kontratës individuale të punës me afat gjatë gjithë kohës së garancisë, e cila të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.
- c) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (*pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (**të markuara sipas artikullit**) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet duhet të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

-
- d) O operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesorët përkatës, në formë tabele, ku të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit.
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.
- f) Deklaratën e Konformitetit të produkteve me standartet CE të lëshuar nga prodhuesi, kur është e aplikueshme, në përputhje me Direktivën Europiane në fuqi
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se merr përsipër instalimin, vënien në punë dhe testimin e pajisjeve të ofertuara në momentin e dorëzimit të tyre.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku të deklarojë se merr përsipër të kryejë trajnimin e stafit nga punonjës të specializuar për përdorimin e pajisjeve objekt prokurimi.
- i) Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë, ku të deklarojë se garanton riparimin dhe furnizimin me pjesë për pajisjet e ofertuara për një periudhë të paktën 5 vjeçare, si dhe për disponimin e ambientit të servisit për kryerjen e shërbimeve të pajisjeve objekt i këtij prokurimi.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Nëse ka emra markash, mund të ofrohet ekuivalenti.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"> Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
